

Mbledhja e Grupit të Ekspertëve të Standardizimit (GES) **(6 mujori i parë, 2010)**

Më datën 05 Shkurt 2010, në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, u zhvillua takimi i Grupit të Ekspertëve të Standardizimit.

Në këtë takim morën pjesë anëtarët e GES: Z. Ilia Gjermani, Z. Dritan Ajdinaj, Znj. Flutur Ahmeti, Z. Agron Laçi, Z. Anesti Ndreu, Z. Alqi Çullaj, Z. Ilir Qerfozi, Z. Islam Cami, Z. Engjëll Çakshiri, Z. Genti Guxho si dhe Znj. Mimoza Cukalla ekspertë të fushave të ndryshme, si dhe Z. Bashkim Muça, Z. Riza Hasanaj, Z. Arben Dervishi, Zsh. Blerina Topçiu, Znj. Suzana Laçi, Z. Pëllumb Metohu, Znj. Arjana Llangozi, Z. Neiron Zaçe, nga DPS.

GES u mbledh për të shqyrtuar, konsultuar dhe marrë vendimin përfundimtar në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me organizimin, koordinimin dhe planifikimin e punës për standardizimin për 6 mujorin e parë të 2010.

- Programin 6- mujor të standardeve që do të miratohen si S SH;
- Propozimet për përbërjen e Komiteteve Teknike;
- Propozimet për kryesimin e këtyre Komiteteve.

Sipas rendit të ditës Drejtori i Përgjithshëm i DPS, Z. Bashkim Muça, e deklaroi mbledhjen të hapur në praninë e shumicës prej 2/3 të anëtarëve të GES-it. Ai falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe për kontributin e vyer në fushën e standardizimit, si dhe i ftoi ata për bashkëpunim të mëtjeshëm profesional.

Më pas fjalën e mori Z. Riza Hasanaj, Drejtor i Drejtorisë së Standardeve, i cili bazuar në *pikën 2* të rendit të ditës, nisi shqyrtimin e standardeve që propozohen të miratohen 6-mujorin e parë të vitit në vazhdim. U diskutua në lidhje me listën e standardeve të reja që do të jenë në plan për tu adoptuar në 6 muajt në vijim, listë kjo që do të përdoret edhe në publikimin periodik të standardeve për mendim publik në buletin.

Në kuadër të *pikës 3 dhe 4* të rendit të ditës Znj. Cukalla bëri disa propozime për ndryshime në përfaqësimin në KT nga Universiteti Politeknik i Tiranës sidomos nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në disa prej Komiteteve Teknike, Nr. 12 “Metrologjia dhe matjet”, 114 “Siguria e makinerisë”, Nr. 138 “Provat pa shkatërrim” etj.

Në lidhje me *pikën 5* të rendit të ditës:

U diskutua në lidhje me përkthimin e standardeve, marrëveshjeve, fushave të preferuara për përkthim etj. Problematikat dhe sugjerimet nga anëtarët si më poshtë:

Z. Ilir Qerfozi:

- Në DPS është përdorur një fjalor terminologjik i cili duhet të vihet në dispozicion të gjithë ekspertëve të përfshirë në procesin e përkthimit të standardeve.
- Problem mbetet përsëri numri i standardeve të përkthyer në gjuhën shqipe dhe cilësia e këtyre përkthimeve.
- Përparësi duhet t'u jepet përkthimeve të standardeve në fushat me më shumë ndikim në ekonominë shqiptare siç janë standardet e fushës së ndërtimit ose në fushën e energjisë.

Znj. Flutura Ahmeti:

- Edhe nga Instituti i Ndërtimit janë bërë disa përkthime të cilat akoma nuk kanë kaluar akoma për shqyrtim në KT përkatëse.

Z. Genti Guxho:

- FIM në bazë të një marrëveshje bashkëpunimi që ka nënshkruar me DPS mund të blejë standarde me gjysmë çmimi, marrëveshje e cila nuk është zbatuar gjithmonë de mbetet për të verifikuar në se kjo marrëveshje vazhdon të jetë në fuqi.
- Në FIM është bërë një punë e konsiderueshme për përkthimin e një grupi standardesh të fushës së tekstileve por këto përkthime nuk kanë kaluar ende në filtrin e KT dhe kanë nevojë për redaktim.

Z. Alqi Çullai:

- Dy vjet më parë DPS publikoi versionin elektronik të ¹Katalogut Shqiptar të Standardeve dhe shpreh preferencën për këtë format katalogu.

Grupi i Ekspertëve miratoi me ndryshimet e propozuara:

- a) listën e standardeve për 6-mujorin e parë të vitit 2010
- b) përbërjen e Komiteteve Teknike

Në lidhje me *pikën 6* të rendit të ditës të gjithë ranë dakord që mbledhja e radhës të zhvillohet në fillim të muajit Korrik 2010 dhe të merren parasysht pikat që u diskutuan dhe u lanë si sugjerime nga anëtarët.

Për më shumë informacion Ju lutemi të na kontaktoni:

Tel: +355 (0) 4 222 62 55
Fax: +355 (0) 4 224 71 77
E-mail: info@dps.gov.al

Gjithashtu mund të vizitoni faqen tonë të internetit:

Web: www.dps.gov.al – Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

Tiranë, më 05.02.2010

¹ Aktualisht Katalogun e Standardeve Shqiptare 2009 mund ta gjeni në format hard copy, në faqen tonë të internetit në linkun: <http://www.dps.gov.al/dpsonline/search.php?gj=Al>, si dhe në CD me një ndërfaqe të thjeshtë përdorimi.